L I G J
Nr.9555, datë 8.6.2006

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS EUROPIANE "PËR STATUSIN LIGJOR TË PUNËTORËVE MIGRANTË"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Konventa Europiane "Për statusin ligjor të punëtorëve migrantë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4939, datë 27.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

HYRJE

Vendet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të kësaj Konvente;

duke mbajtur në konsideratë faktin se vizioni i Këshillit të Europës është të arrijë një unitet më të madh midis vendeve anëtare të tij, me qëllim ruajtjen dhe realizimin e idealeve dhe parimeve që janë trashëgimi e përbashkët, lehtësimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, si dhe respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;

duke pasur parasysh që statusi ligjor i punëtorëve migrantë të cilët janë shtetas të vendeve anëtare të Këshillit të Europës duhet të standardizohet në mënyrë që të sigurohet trajtimi sa më mirë i tyre dhe me kushte jo më të këqija sesa punëtorët shtetas të vendeve pritëse në të gjitha aspektet e jetesës dhe standardeve të punës;

duke qenë të vendosur për të lehtësuar më tej zhvillimin shoqëror të punëtorëve migrantë dhe të pjesëtarëve të familjeve tyre;

duke pranuar se të drejtat dhe privilegjet që këto vende u japin shtetasve të njëri-tjetrit janë përcaktuar në bazë të marrëdhënieve më të ngushta që i bashkojnë vendet anëtare të Këshillit të Europës nëpërmjet statusit të tij,

janë marrë vesh për sa vijon.

KREU I

Neni 1
Përkufizime

1. Në përputhje me qëllimet e kësaj konvente, termi "Punëtor migrant" do të nënkuptojë një

shtetas të një pale kontraktuese, i cili është autorizuar nga një tjetër palë kontraktuese për të qëndruar në territorin e vet, në mënyrë që të punësohet në këmbim të një pagese.

2. kjo Konventë nuk do të zbatohet:

a) për punonjësit e kufirit;

b) për artistët dhe persona të ngjashëm me ta, për sportistët e punësuar për një kohë të shkurtër, si dhe për profesionistët e lirë;

c) për marinarët;

d) për personat në proces kualifikimi;

e) për punëtorët sezonalë; punëtorët migrantë sezonalë janë ata të cilët, duke qenë shtetas të njërës nga palët kontraktuese, janë të punësuar mbi bazën e një kontrate në territorin e një pale tjetër kontraktuese në një veprimtari për një periudhë të caktuar apo për një punë të caktuar që varet nga ritmi i sezonit;

f) për punëtorët që janë shtetas të njërës palë kontraktuese, të cilët bëjnë një punë të caktuar në territorin e një pale tjetër kontraktuese për llogari të një sipërmarrjeje, e cila ka zyrën e vet të regjistruar jashtë territorit të asaj pale kontraktuese.

KREU II

Neni 2
Format e rekrutimit

1. Rekrutimi i punëtorëve të ardhshëm migrantë mund të kryhet nëpërmjet kërkesave nominative ose jonominative dhe, në rastin e fundit, do të kryhet me ndërmjetësinë e autoritetit zyrtar të shtetit të origjinës, nëse ekziston një autoritet i tillë, dhe aty ku është e përshtatshme, me ndërmjetësinë e autoritetit zyrtar të shtetit pritës.

2. Kostot administrative të rekrutimit, të hyrjes dhe vendosjes në shtetin pritës, nuk do të përballohen nga punëtori i ardhshëm migrant në rast se këto veprime kryhen nga një autoritet zyrtar.

Neni 3
Analizat mjekësore dhe provimi i aftësisë

1. Rekrutimi i punëtorëve migrantë mund të paraprihet prej analizave mjekësore dhe provimit të aftësisë.

2. Analizat mjekësore dhe provimi i aftësisë kanë për qëllim të përcaktojnë nëse punëtori i ardhshëm migrant është i aftë fizikisht dhe mendërisht dhe i kualifikuar teknikisht për punën që i është ofruar ai dhe të sigurojnë që gjendja e tij shëndetësore nuk përbën asnjë rrezik për shëndetin publik.

3. Masat për kompensimin e shpenzimeve që lidhen me analizat mjekësore dhe provimet e aftësisë do të përcaktohen në përputhje me marrëveshjet dypalëshe për të siguruar që këto shpenzime të mos bien mbi punëtorin e ardhshëm migrant.

4. Një punëtori migrant, të cilit i është bërë një ofertë pune nominative nuk do t'i kërkohet të hyjë në një provim aftësie, përveç rastit ku dyshohet për mashtrim, si dhe rastit kur për këtë gjë është paraqitur një kërkesë nga vetë punëdhënësi.

Neni 4
E drejta për të dalë nga një territor; e drejta për të hyrë në një territor; formalitetet administrative

1. Çdonjëra nga palët kontraktuese do t'u garantojë të drejtat e mëposhtme punëtorëve migrantë:

- të drejtën për të dalë nga territori i palës kontraktuese, shtetas të së cilës ata janë;

- të drejtën për të hyrë në territorin e një pale kontraktuese për t'u punësuar pasi të jenë autorizuar dhe pasi të kenë marrë dokumentet e nevojshme për ta bërë këtë gjë.

2. Këto të drejta do jenë subjekt kufizimesh, të parashikuara në ligj, në rast cenimi të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit publik, si dhe të moralit publik.

3. Dokumentet që i kërkohen punëtorit migrant për emigrim apo imigrim do të lëshohen sa më

shpejt të jetë e mundur dhe pa pagesë apo kundrejt pagesës së një shume e cila nuk e kalon koston administrative të tyre.

Neni 5
Formalitetet dhe procedura në lidhje me kontratën e punës

Çdo punëtor migrant i pranuar për punësim do të pajiset para nisjes për në shtetin pritës me një kontratë punësimi ose me një ofertë të përcaktuar punësimi, çdonjëra prej të cilave mund të paraqitet në një ose disa prej gjuhëve që përdoren në shtetin e origjinës ose në ose disa prej gjuhëve që përdoren në shtetin pritës. Përdorimi i njërës nga gjuhët e përdorura në shtetin e origjinës dhe njërës nga gjuhët e përdorura në shtetin pritës do të jetë e detyrueshme në rastin e rekrutimit nga një autoritet zyrtar ose nga një zyrë punësimi e njohur zyrtarisht.

Neni 6
Informacioni

1. Palët kontraktuese do të shkëmbejnë dhe do t'u sigurojnë migrantëve të ardhshëm informacionin e duhur për rezidencën, kushtet dhe mundësitë e bashkimit familjar, natyrën e punës, mundësinë e lidhjes së një kontrate të re pune në përfundim të kontratës së parë, kualifikimet e nevojshme, kushtet e punës dhe të jetesës (përfshi dhe koston e jetesës), pagesën, sigurimet shoqërore, banesën, ushqimin transferimin e kursimeve, udhëtimin dhe zbritjet nga pagesa për sigurimet shoqërore dhe për mbrojtjen shoqërore, taksat dhe detyrimet e tjera. Gjithashtu mund të sigurohet informacion edhe për kushtet kulturore dhe fetare të shtetit pritës.

2. Në rastin e punësimit nëpërmjet një autoriteti zyrtar të shtetit pritës, ky informacion do të sigurohet përpara nisjes në një gjuhë që punëtori i ardhshëm migrant mund ta kuptojë, për ta ndihmuar atë të marrë një vendim bazuar në njohjen e plotë të fakteve. Përkthimi i këtij informacioni, atëherë kur është e nevojshme, në një gjuhë që punëtori i ardhshëm migrant mund ta kuptojë, do të bëhet, si rregull i përgjithshëm, nga shteti i origjinës.

3. Çdonjëra nga palët kontraktuese do të ndërmarrë masat e duhura për të parandaluar propagandën e gabuar në lidhje me emigrimin dhe imigrimin.

Neni 7
Udhëtimi

1. Çdonjëra nga palët kontraktuese do të marrë përsipër që, në rast rekrutimi zyrtar kolektiv, kostoja e udhëtimit për në shtetin pritës të mos përballohet në asnjë mënyrë nga punëtori migrant. Mënyra e pagesës do të përcaktohet në një marrëveshje dypalëshe që mund t'i shtrijë këto efekte edhe për familje dhe për punëtorët e rekrutuar individualisht.

2.Në rastin e punëtorëve migrantë dhe familjeve të tyre që udhëtojnë transit në territorin e një pale kontraktuese me destinacion shtetin pritës apo në kthim për në shtetin e origjinës, autoritetet kompetente të shtetit ku do të bëhet transiti do të ndërmarrin të gjitha masat për të shpejtuar udhëtimin e tyre dhe për të shmangur vonesat dhe vështirësitë administrative.

3.Çdonjëra nga palët kontraktuese do të çlirohet nga detyrimet dhe taksat e importit gjatë hyrjes në shtetin pritës, gjatë transitit dhe gjatë kthimit përfundimtar në shtetin e origjinës për:

a)sendet personale dhe pasuritë e luajtshme të punëtorëve migrantë dhe të pjesëtarëve të tjerë që i përkasin familjeve të tyre; dhe/ose

b)një sasi të arsyeshme veglash dhe pajisjesh pune të punëtorëve migrantë të nevojshme për punën të cilën do të fillojnë.

Përjashtimet e përmendura më sipër do të kryhen në përputhje me ligjin e brendshëm apo rregullat e shteteve për të cilat bëhet fjalë.

KREU III

Neni 8
Leja e punës

1. Çdonjëra nga palët kontraktuese, që lejon një punëtor migrant të hyjë në territorin e saj për të punuar, do të lëshojë apo rinovojë për të një leje pune (me përjashtim të rastit kur ai përjashtohet nga kjo kërkesë) në përputhje me kushtet e përcaktuara në legjislacionin e vet.

2. Megjithatë, leja e punës e lëshuar për herë të parë nuk e kufizon punëtorin që të qëndrojë detyrimisht tek i njëjti punëdhënës apo në të njëjtin rajon për një periudhë kohe më të gjatë se një vit.

3. Rinovimi i lejes së punës së punëtorit migrant, si rregull, do të bëhet për një periudhë kohe të paktën 1-vjeçare, nëse gjendja aktuale dhe zhvillimi i pritshëm i situatës së punësimit në atë vend e mundëson këtë gjë.

Neni 9
Leja e qëndrimit

1. Çdonjëra nga palët kontraktuese do t'i japë lejeqëndrimi punëtorëve migrantë të autorizuar të punojnë në territorin e tyre sipas kushteve të përcaktuara në këtë Konventë në rast se kjo kërkohet nga legjislacioni i brendshëm i palës.

2. Leja e qëndrimit do të jepet në përputhje me legjislacionin e vendit dhe, nëse është e nevojshme, do të rinovohet për një periudhë që, si rregull, është të paktën sa kohëzgjatja e lejes së punës. Kur leja e punës është me kohëzgjatje të papërcaktuar, leja e qëndrimit do të lëshohet dhe, në rast se është e nevojshme, do të rinovohet për një periudhë të paktën 1-vjeçare. Leja do të lëshohet dhe rinovohet pa pagesë apo kundrejt pagesës së një shume e cila nuk e kalon koston administrative të tyre.

3. Masat e përcaktuara në këtë nen do të zbatohen edhe për pjesëtarët e familjeve të punëtorëve migrantë të autorizuar për t'iu bashkuar atyre në përputhje me nenin 12 të kësaj Konvente.

4. Nëse një punëtor migrant është i papunë për shkak të paaftësisë, rrjedhojë e një sëmundjeje, një aksidenti, dëshirës apo vullnetit të tij të lirë, subjekt i konfirmimit zyrtar nga autoritetet kompetente, ky do të lejohet të qëndrojë në territorin e shtetit pritës për një periudhë kohe jo më pak se 5 muaj në përputhje me nenin 25 të kësaj Konvente. Megjithatë asnjë nga palët kontraktuese, në rastin e nënparagrafit të mësipërm, nuk është e detyruar t'a lejojë punëtorin migrant të qëndrojë për një periudhë kohe më të gjatë sesa periudha e pagesës së papunësisë.

5. Leja e qëndrimit, e lëshuar në përputhje me dispozitat e paragrafëve 1-3 të këtij neni, mund të hiqet:

a) për arsye që lidhen me sigurinë kombëtare në përputhje, politikën kombëtare apo moralin publik;

b) nëse mbajtësi i lejes refuzon, pasi është njoftuar për pasojat e këtij refuzimi, t'u nënshtrohet masave që janë përcaktuar për të nga një autoritet zyrtar mjekësor për mbrojtjen e shëndetit publik;

c) nëse një kusht thelbësor për lëshimin apo për vlefshmërinë e lejes nuk është përmbushur. Megjithatë çdonjëra nga palët kontraktuese merr përsipër t'i garantojë punëtorit migrant, të cilit i është hequr leja, të drejtën e apelimit pranë autoritetit përkatës gjyqësor apo administrativ, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm.

Neni 10
Pritja

1. Pas mbërritjes në shtetin pritës, punëtorëve migrantë dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre do t'u jepet i gjithë informacioni, këshillat përkatës, si dhe asistenca e nevojshme për vendosjen dhe përshtatjen e tyre.

2. Për këtë qëllim punëtorëve migrantë dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre do t'u jepet ndihmë dhe asistencë nga shërbimet sociale të shtetit pritës ose prej organizmave që punojnë për interesin publik në shtetin pritës dhe ndihmë nga autoritetet konsullore të shtetit të tyre të origjinës. Veç kësaj, punëtorëve migrantë do t'u sigurohen nga autoritetet e punësimit kushte të njëjta për ndihmë dhe asistencë me ato të punëtorëve vendas. Megjithatë, çdonjëra nga palët kontraktuese do të përpiqet të sigurojë mundësimin e shërbimeve sociale të posaçme, atëherë kur kjo të jetë e nevojshme, për të

lehtësuar apo për të bashkërenduar pritjen e punëtorëve migrantë dhe të familjeve të tyre.

3. Çdonjëra prej palëve kontraktuese merr përsipër të sigurojë që punëtorët migrantë dhe familjet e tyre të mund të ushtrojnë lirisht besimin në përputhje me fenë e tyre; çdonjëra nga palët kontraktuese do ta lehtësojë ushtrimin e këtij besimi brenda mundësive të veta.

Neni 11

Pagimi i shpenzime të detyrueshme për mbajtjen e personave në ngarkim

1. Statusi i punëtorëve migrantë nuk do të përplaset me detyrimin e punëtorit migrant për pagimin e shpenzimeve për kujdesin apo mbajtjen e personave të tjerë në shtetin e origjinës, që burojnë nga lidhjet familjare farefisnore, martesore apo të ngjashme, përfshi këtu edhe detyrimin për mbajtjen e një fëmije të jashtëligjshëm

2. Çdonjëra nga palët kontraktuese do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të siguruar pagimin e këtyre detyrimeve duke iu përshtatur sa më shumë të jetë e mundur formës së miratuar nga Këshilli i Ministrave të Këshillit të Evropës.

3. Brenda mundësive të veta, çdonjëra nga palët kontraktuese do të ndërmarrë hapa për të caktuar një autoritet të vetëm për të pranuar dhe shpërndarë aplikimet për pagimin e shpenzimeve të përcaktuara në paragrafin 1 më lart.

4. Ky nen nuk do të ketë pasoja mbi marrëveshjet ekzistuese apo të ardhshme dypalëshe apo shumëpalëshe.

Neni 12

Bashkimi familjar

1. Bashkëshorti/ja i punëtorit migrant të punësuar ligjërisht në territorin e njërës palë kontraktuese dhe fëmijët e pamartuar që konsiderohen të mitur nga legjislacioni përkatës i shtetit pritës, në varësi të punëtorit migrant, kanë të drejtë të bashkohen me punëtorin migrant në territorin e palës kontraktuese, me kusht që kjo e fundit të ketë mundësi strehimi për familjen me kushte të njëjta me ato të punëtoreve vendas në zonën ku punëtori migrant është i punësuar, sipas dispozitave që përcakton kjo Konventë dhe në përputhje me procedurën e pranimit të përcaktuar nga legjislacioni përkatës apo nga marrëveshjet ndërkombëtare. Çdo palë kontraktuese mund ta kushtëzojë dhënien e autorizimit me një periudhë pritjeje që nuk duhet të jetë më e gjatë se 12 muaj.

2. Çdo shtet mundet që në çdo kohë, me anën e një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, e cila hyn në fuqi një muaj pas datës së marrjes prej tij, t'i referohet paragrafit 1 në lidhje me bashkimin familjar të kushtëzuar nga mjetet e mjaftueshme të punëtorit migrant për të plotësuar nevojat e familjes së tij.

3. Çdo shtet mundet që në çdo kohë, me anën e një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës e cila hyn në fuqi një muaj pas datës së marrjes prej tij, të tërhiqet përkohësisht nga detyrimi për dhënien e autorizimit që përcakton paragrafi 1, për një ose disa pjesë të territorit që do të përcaktohen në atë deklaratë, me kusht që këto masa të mos krijojnë përplasje me detyrimet që rrjedhin prej instrumenteve të tjera ndërkombëtare. Deklarata do të përmbajë arsyet e veçanta të tërheqjes nga detyrimi, arsye që lidhen me kapacitetin pritës.

4. Çdo shtet që ndërmerr masën e tërheqjes nga detyrimi do të informojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për masat që ka marrë dhe do të sigurojë që këto masa të bëhen sa më shpejt publike. Ai gjithashtu do të informojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës kur këto masa nuk zbatohen më dhe kushtet e Konventës nisin sërish të zbatohen plotësisht.

5. Tërheqja nga detyrimi nuk do të zbatohet, si rregull, për kërkesat për bashkim familjar që u janë bërë autoriteteve përkatëse përpara deklaratës së adresuar te Sekretari i Përgjithshëm nga punëtorët migrantë të vendosur tashmë në pjesën e territorit për të cilën bëhet fjalë.

Neni 13

Strehimi

1. Çdo palë kontraktuese do të bëjë të mundur për punëtorët migrantë kushte strehimi dhe qiraje jo më të këqija sesa ato të punëtorëve vendas në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse.

2. Çdo palë kontraktuese do të bëjë të mundur që autoritetet kompetente kombëtare të bëjnë inspektime në bashkëpunim me autoritetet përkatëse konsullore, duke vepruar brenda kompetencave të tyre, për t'u siguruar që standardet e strehimit të punëtorëve migrantë të jenë të barabarta me ato të punëtorëve vendas.

3. Çdo palë kontraktuese do të marrë përsipër të mbrojë punëtorët migrantë nga shfrytëzimi për sa i përket qirasë, në përputhje me ligjet dhe rregullat e saj për këtë çështje.

4. Çdo palë kontraktuese do t'u sigurojë punëtorëve migrant, me mjetet që kanë në dispozicion autoritetet kombëtare, një strehim të përshtatshëm.

Neni 14

Parakualifikimi, shkollimi, kualifikimi gjuhësor, kualifikimi dhe rikualifikimi profesional

1. Punëtorët migrantë dhe pjesëtarët e familjeve të tyre të pranuar zyrtarisht në territorin e një pale kontraktuese do të kryejnë, mbi të njëjtën bazë dhe në të njëjtat kushte me ato të punëtorëve vendas, arsimin e përgjithshëm dhe kualifikimin dhe rikualifikim profesional dhe do të kenë mundësinë të ndjekin arsimin në një nivel më të lartë në përputhje me rregullat e përgjithshme që rregullojnë pranimin në institucionet përkatëse të shteteve pritëse.

2. Për të nxitur futjen në shkolla të përgjithshme dhe profesionale dhe në qendrat e kualifikimit profesional, shteti pritës do të lehtësojë mësimin e gjuhës së tij ose, nëse atje përdoren disa gjuhë, njërën prej gjuhëve për punëtorët migrantë dhe pjesëtarët e familjeve të tyre.

3. Për zbatimin e paragrafëve 1 dhe 2 të përcaktuar më lart, e drejta e shkollimit do të lihet në kompetencën e secilës palë kontraktuese, e cila do të bëjë për përpjekjet për t'u mundësuar fëmijëve të punëtorëve migrantë të cilët jetojnë me familjet e tyre në shtetin pritës- në përputhje me masat e përcaktuara nga neni 12 i kësaj Konvente - të njëjtat lehtësira si edhe vendasve.

4. Kualifikimet e mëparshme të punëtorit si diplomat dhe kualifikimet profesionale të marra në shtetin e origjinës do të njihen nga çdo palë kontraktuese në përputhje me marrëveshjet dypalëshe apo shumëpalëshe.

5. Palët kontraktuese, duke vepruar në bashkëpunim të ngushtë, do të përpiqen për të siguruar që skemat e trajnimit dhe ritrajnimit profesional, brenda kontekstit të këtij neni, të plotësojnë sa më shumë të jetë e mundur nevojat e punëtorëve migrantë duke konsideruar kthimin e tyre në shtetin e origjinës.

Neni 15

Mësimi i gjuhës amtare të punëtorit migrant

Palët kontraktuese do të ndërmarrin veprime në bazë marrëveshjesh të përbashkëta për të mundësuar, sa më shumë që të jetë e mundur, kurse të veçanta për fëmijët e punëtorëve migrantë për mësimin e gjuhës amtare për të lehtësuar kthimin e tyre në shtetin e origjinës.

Neni 16

Kushtet e punës

1. Për sa u përket kushteve të punës, punëtorët migrantë të autorizuar për të punuar do të trajtohen në mënyrë jo më pak të favorshme sesa punëtorët vendas në përputhje me masat legjislative apo administrative, me marrëveshjet e punësimit kolektiv apo konventat.

2. Parimi i trajtimit të barabartë i përcaktuar në paragrafin e mësipërm nuk mund të shmanget nëpërmjet përdorimit të kontratave individuale.

Neni 17
Transferimi i kursimeve

1. Çdo palë kontraktuese do të lejojë, në përputhje me marrëveshjet e përcaktuara nga legjislacioni i saj, transferimin e plotë apo të pjesshëm të fitimeve apo të kursimeve të punëtorëve migrantë sipas dëshirës së tyre.

2. Kjo masë do të zbatohet gjithashtu edhe për shumat të cilat punëtori migrant i detyrohet personave të tjerë. Transferimi i shumave për mbajtjen e personave të tjerë në ngarkim në shtetin e origjinës nuk do të ndalohet apo parandalohet në asnjë mënyrë.

3. Çdo palë kontraktuese do të 1ejojë, mbi bazën e marrëveshjeve dypalëshe apo me anën e mjeteve te tjera, transferimin e shumave që u detyrohet ende punëtorëve migrantë kur ata largohen nga territori i shtetit pritës.

Neni 18
Sigurimet shoqërore

1. Çdo Palë Kontraktuese do të marrë përsipër brenda territorit të saj trajtimin e barabartë të punëtorëve migrantë dhe familjeve të tyre me vendasit për çështjen e sigurimeve shoqërore, në bazë të kushteve të kërkuara nga legjislacioni vendas dhe marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe tashmë të përfunduara apo që do të përfundohen ndërmjet palëve përkatëse kontraktuese.

2. Palët kontraktuese do të përpiqen gjithashtu t'u sigurojnë punëtorëve migrantë dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre ruajtjen e të drejtave të fituara apo në proces fitimi, si edhe të përfitimeve të tjera jashtë shtetit, nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe.

Neni 19
Asistenca sociale dhe mjekësore

Çdo palë kontraktuese merr përsipër t'u japë asistencë sociale dhe mjekësore punëtorëve migrantë dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre, të cilët qëndrojnë ligjërisht brenda territorit të saj njësoj si shtetasve të vet, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare dhe në veçanti nga Konventa Europiane për Asistencë Sociale dhe Mjekësore e vitit 1953.

Neni 20
Aksidentet industriale dhe sëmundjet profesionale, higjiena industriale

1. Duke synuar parandalimin e aksidenteve industriale dhe sëmundjeve profesionale si dhe higjienën industriale, punëtorët migrantë do të përfitojnë të njëjtat të drejta dhe mbrojtje si punëtorët vendas, në zbatim të ligjeve të një pale kontraktuese dhe marrëveshjeve kolektive dhe duke pasur parasysh situatat e veçanta.

2. Një punëtor migrant, i cili është viktimë e një aksidenti industrial apo ka marrë një sëmundje profesionale në territorin e shtetit pritës, do të përfitojë rehabilitim profesional në të njëjtat kushte si ato të punëtorëve vendas.

Neni 21
Kontrolli i kushteve të punës

Çdo palë kontraktuese do të kontrollojë ose do të krijojë mundësinë për kontrollin e kushteve të punës së punëtorëve migrantë njësoj si edhe për punëtorët vendas. Një kontroll i tillë do të bëhet nga organizmat apo institucionet përkatëse të shtetit pritës dhe nga çdo autoritet tjetër i autorizuar për këtë gjë nga shteti pritës.

Neni 22
Vdekja

Çdo palë kontraktuese do të kujdeset, brenda kuadrit të saj ligjor dhe, nëse është nevoja,

brenda kuadrit të marrëveshjeve dypalëshe, që të ndërmerren hapa për të siguruar asistencën e nevojshme për transportimin në shtetin e origjinës të trupave të punëtorëve migrantë të cilët kanë vdekur si rezultat i një aksidenti industrial.

Neni 23
Tatimi mbi të ardhurat

1. Në lidhje me të ardhurat dhe pa paragjykuar masat e marra për tatimin e dyfishtë që përfshihen në marrëveshjet që janë përfunduar ose që mund të përfundohen në të ardhmen ndërmjet palëve kontraktuese, punëtorët migrantë nuk do të mbajnë përgjegjësi në territorin e një pale kontraktuese, për detyrime, taksa apo kontribute më të mëdha sesa ato që aplikohen për vendasit në të njëjtat rrethana. Në veçanti, punëtorët migrantk do të kenë të drejtën e zbritjes apo përjashtimit nga taksat të të gjitha shumave të paguara si detyrime të caktuara, përfshi ato për mbajtjen e personave në ngarkim.

2. Palët kontraktuese do të vendosin bashkërisht masat që duhet të merren për të shmangur tatimin e dyfishtë mbi të ardhurat e punëtorëve migrantë me anën e marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe.

Neni 24
Mbarimi i kontratës dhe largimi nga puna

1. Me mbarimin e një kontrate pune të lidhur për një periudhë të caktuar kohe, në fund të periudhës së caktuar dhe në rastin e prishjes së kësaj kontrate apo prishjes së një kontrate pune të lidhur për një periudhë të papërcaktuar kohe, punëtorët migrantë do të trajtohen në një mënyrë jo më pak të favorshme sesa trajtimi që u bëhet punëtorëve vendas në zbatim të ligjit vendas ose marrëveshjeve kolektive të punësimit.

2. Në rast largimi individual apo kolektiv nga puna, punëtorët migrantë do të trajtohen në mënyrë të njëjtë me punëtorët vendas, në përputhje me ligjin vendas ose me marrëveshjet kolektive të punësimit për sa u përket formave dhe periudhës së paralajmërimit, shpërblimin e garantuar për këtë sipas ligjit ose marrëveshjeve siç mund të jetë rasti i prishjes pa paralajmërim të kontratave të tyre të punës.

Neni 25
Ripunësimi

1. Nëse një punëtor migrant e humbet punën për arsye që nuk varen prej tij, si sëmundje të shpeshta apo për një periudhë të gjatë kohe, autoriteti kompetent i shtetit pritës do të lehtësojë ripunësimin e tij në përputhje me ligjet dhe rregullat e atij shteti.

2. Për këtë qëllim shteti pritës do të marrë masat e nevojshme për të siguruar, sa më shumë të jetë e mundur, rikualifikimin profesional dhe rehabilitimin në punë të punëtorit migrant në fjalë, nëse ai synon të vazhdojë të jetë i punësuar në këtë shtet.

Neni 26
E drejta për t'u drejtuar në gjykatë dhe pranë autoriteteve administrative në shtetin pritës

1. Çdo palë kontraktuese do t'u sigurojë punëtorëve migrantë trajtim jo më pak të favorshëm në lidhje me procedurat ligjore. Punëtorëve migrantë do t'u jepet, me të njëjtat kushte si edhe vendasve, mbrojtje e plotë ligjore dhe gjyqësore e personit, e të drejtave dhe e interesave të tyre; në mënyrë të veçantë ata do të kenë, në të njëjtën mënyrë si edhe vendasit, të drejtën të drejtohen në autoritetet kompetente gjyqësore dhe administrative në përputhje me ligjin e shtetit pritës, si dhe të drejtën për të pasur asistencën e kujtdo personi që ata do të zgjedhin, i cili është i kualifikuar sipas ligjeve të atij shteti, për shembull në mosmarrëveshjet me punëdhënësit, me pjesëtarët e familjeve apo me të tretët. Dispozitat e së drejtës private dhe asaj ndërkombëtare të shtetit përkatës nuk do të preken nga ky nen.

2. Çdo palë kontraktuese do t'u sigurojë punëtorëve migrantë asistencë ligjore në të njëjtat

kushte si shtetasve të vet dhe, në rast çështjesh civile apo penale, mundësinë e ndihmës më përkthyes nëse ata nuk kuptojnë apo flasin gjuhën e përdorur në gjykatë.

Neni 27
Përdorimi i shërbimeve të punësimit

Çdo palë kontraktuese njeh të drejtën e punëtorëve migrantë dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre të pranuar zyrtarisht në territorin e saj të përdorin shërbimet e punësimit me të njëjtat kushte si punëtorët vendas sipas praktikave ligjore, rregulloreve dhe praktikave administrative përfshi edhe kushtet e pranimit, që janë në fuqi në atë shtet.

Neni 28
Ushtrimi i së drejtës për t'u organizuar

Çdo palë kontraktuese do t'u lejojë punëtorëve migrantë të drejtën të organizohen për mbrojtjen e interesave të tyre ekonomike dhe shoqërore në kushte të njëjta me ato që përcakton ligji vendas për shtetasit e vet.

Neni 29
Pjesëmarrja në veprimtaritë e sipërmarrjes

Çdo palë kontraktuese do të lehtësojë sa më shumë të jetë e mundur pjesëmarrjen e punëtorëve migrantë në veprimtaritë e sipërmarrjes në të njëjtat kushte si punëtorëve vendas.

KREU IV

Neni 30
Kthimi

1. Çdonjëra palë kontraktuese do të marrë masat e duhura, për aq sa është e mundur, për të ndihmuar punëtorët migrantë dhe familjet e tyre në rastin e kthimit të tyre në shtetin e origjinës dhe në veçanti masat që lidhen me paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7 të kësaj Konvente. Marrja e masave për ndihmë financiare është e drejtë e secilës palë kontraktuese.

2. Për të bërë të mundur që punëtorët migrantë të vihen në dijeni para se të ndërmarrin udhëtimin e kthimit për kushtet në të cilat do të mund të risistemohen në shtetin e origjinës, ky shtet do të komunikojë me shtetin pritës, i cili do të vërë në dispozicion të atyre që kërkojnë, informacione që në veçanti kanë të bëjnë me:

- mundësitë dhe kushtet e punësimit në shtetin e origjinës;
- ndihmën financiare që jepet për riintegrim ekonomik;
- ruajtjen e të drejtave të sigurimeve shoqërore që kanë përfituar jashtë shtetit;
- hapat që duhen ndërmarrë për te lehtësuar akomodimin e tyre;
- njohjen e kualifikimeve profesionale që janë marrë jashtë shtetit dhe provimet që duhen dhënë për të siguruar njohjen e tyre zyrtare;
- njohjen e kualifikimeve arsimore, që fëmijët e punëtorëve migrantë të mund të pranohen në shkollë pa u ulur në nivel.

KREU V

Neni 31
Ruajtja e të drejtave të fituara

Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet sikur justifikon trajtimin më pak të favorshëm sesa ai që gëzojnë punëtorët migrantë nga legjislacioni i shtetit pritës apo nga marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, palë e të cilave është shteti në fjalë.

Neni 32

Lidhjet ndërmjet kësaj konvente dhe ligjeve të palëve kontraktuese apo marrëveshjeve ndërkombëtare

Masat e kësaj Konvente nuk do të paragjykojnë dispozitat e ligjeve të palëve kontraktuese apo të traktateve dypalëshe apo shumëpalëshe, konventave, marrëveshjeve etj., si edhe hapat e ndërmarra për t'i zbatuar ato, të cilat janë në fuqi ose mund të hyjnë në fuqi, dhe në zbatim të të cilave u është dhënë ose do t'u jepet trajtim më i favorshëm personave që mbrohen nga Konventa.

Neni 33

Zbatimi i Konventës

1. Një komitet konsultativ do të ngrihet brenda një viti nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente.
2. Çdo palë kontraktuese do të caktojë një përfaqësues në Komitetin Konsultativ. Çdo vend tjetër i Këshillit të Evropës mund të përfaqësohet nga një vëzhgues me të drejtë fjale.
3. Komiteti Konsultativ do të shqyrtojë çdo propozim që i paraqitet nga njëra prej palëve kontraktuese për të lehtësuar ose përmirësuar zbatimin e Konventës si edhe propozimet që bëhen për amendimin e saj.
4. Mendimet dhe rekomandimet e Komitetit Konsultativ do të pranohen me shumicën e anëtarëve të Komitetit, ndërsa propozimet për amendimin e Konventës do të pranohen unanimisht nga të gjithë anëtarët e komitetit.
5. Mendimet, rekomandimet dhe propozimet e Komitetit Konsultues për sa më sipër do t'i adresohen Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës që do të vendosë për vendimin që do të merret.
6. Komiteti Konsultativ do të thirret nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës dhe do të mblidhet, si rregull, të paktën çdo dy vjet dhe veç kësaj kurdo që të paktën dy palë kontraktuese ose Komiteti i Ministrave e kërkon këtë. Komiteti do të mblidhet gjithashtu me kërkesën e një pale kontraktuese kur zbatohen masat e përcaktuara nga paragrafi 3 i nenit 12.
7. Komiteti Konsultativ do t'i hartojë periodikisht Komitetit të Ministrave një raport që do të përmbajë informacion mbi ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e palëve kontraktuese në lidhje me çështjet që trajton kjo Konventë.

KREU VI

Neni 34

Firmosja, ratifikimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do te jetë e hapur për t'u firmosur nga vendet anëtare të Këshillit të Europës, subjekt ratifikimi, pranimi ose miratimi. Instrumentet e ratifikimit, pranimit apo miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.
2. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të tretë pas datës së depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit, pranimit apo miratimit.
3. Për sa i përket ratifikimit, pranimit apo miratimit nga një shtet që e ka firmosur, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të tretë pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit apo miratimit.

Neni 35

Shtrirja territoriale

1. Çdo shtet mundet që, në kohën kur firmos apo kur depoziton instrumentin e ratifikimit, pranimit apo miratimit në një datë të mëvonshme, me anën e një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, ta shtrijë zbatimin e kësaj Konvente tek të gjithë apo një pjesë nga territori i vet për lidhjet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës ose në emër të të cilit është i autorizuar të ndërmarrë nisma.

2. Çdo deklaratë e bërë në vijim të paragrafit pararendës në lidhje me territorin e përmendur në deklaratë mund të tërhiqet. Kjo tërheqje do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pasi deklarata e tërheqjes merret nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 36
Rezervat

1. Çdo palë kontraktuese mundet që në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit apo miratimit të shprehë një ose disa rezerva lidhur me jo më shumë se nëntë nene të kapitujve II deri IV përveç nene 4, 8, 9, 12, 16, 17, 20, 25, 26.

2. Çdo palë kontraktuese mundet që në çdo kohë të tërheqë pjesërisht ose plotësisht rezervat e shprehura në përputhje me paragrafin pararendës me anën e një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës që do të hyjë në fuqi që nga data e marrjes prej tij.

Neni 37
Denoncimi i Konventës

1. Çdo palë kontraktuese mund ta denoncojë këtë Konventë me anën e një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës që do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes prej tij.

2. Asnjë denoncim s'mund të bëhet brenda pesë viteve nga data e hyrjes në fuqi të konventës në lidhje me palën kontraktuese në fjalë.

3. Çdo palë kontraktuese e cila s'do jetë më anëtare e Këshillit të Europës s'do të jetë më palë në këtë Konventë gjashtë muaj pas datës kur humbet cilësinë e të qenit anëtare e Këshillit të Europës.

Neni 38
Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i njoftojë shtetet anëtare të Këshillit:

a) për çdo firmosje;

b) për çdo depozitim instrumenti ratifikimi, pranimi apo miratimi;

c) për çdo njoftim të marrë në lidhje me paragrafët 2 dhe 3 të nenit 12;

d) për çdo datë hyrjeje në fuqi të kësaj Konventë në përputhje me nenin 34 të saj;

e) për çdo deklarate të marrë në përputhje me dispozitat e nenit 35;

f) për çdo rezervë të shprehur në përputhje me masat e paragrafit 1 të nenit 36;

g) për çdo tërheqje të rezervave në përputhje me masat e përcaktuara nga paragrafi 2 i nenit 36;

h) për çdo njoftim të marrë në përputhje me masat e nenit 37 dhe për datën kur bëhet padia.

Në dëshmi të sa mësipërm, nënshkruesit, të autorizuar posaçërisht për këtë qëllim, kanë firmosur këtë Konventë.

Bërë në Strasburg, më 24 nëntor 1977, në një origjinal të vetëm në gjuhët frënge dhe angleze të dy tekstet njëlloj të besueshme që do të depozitohen në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'u dërgojë nga një kopje të vërtetuar secilit nga shtetet nënshkruese.